



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

V E N D I M

Nr. 55 Datë 23.08.2012

**PËR PJESËMARRJEN E BASHKISË KUÇOVË SI AKSIONAR I VETËM NË
SHOQËRINË "K. F. NAFTËTARI" SH.A**

Mbështetur në ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe Funkionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 8, pika VI gërma b, në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", në ligjin 9376 date 21.04.2005 "Per sportin" (I ndryshuar) , në mbledhjen e datës 23.8.2012 Këshilli i Bashkisë Kuçovë mori në konsiderate Vendimin e mbledhjes se pergjitheshme te Asamblese se ortakeve te Shoqerise "K.F.Naftetari" sh.a. "Per largimin e ortakut dhe shitjen e kuotave perkatese " dhe pas diskutimit ,

V E N D O S I

1. Bashkia Kuçovë të pranoje dhurimin e kuotave (kontributeve) në masën 70% që ortakut Beshir Troka zoteron në Shoqërinë "F.K NAFTËTARI" SH.A .
2. Bashkia Kuçovë të marrë pjesë si Aksionar i Vetëm në Shoqërinë "F.K NAFTËTARI" SH.A duke zotëruar 100% të kapitalit themelues të shoqërisë , si dhe të bëjë regjistrimin e Shoqërisë me ndryshimet përkatëse në Q.K.R .
3. Pranimin e dorëheqjes së z.Bahri Hazizaj nga Kryetar i Keshillit Mbikëqyres dhe emerimin e z. Shpetim Nishani , I biri i Dautit , shtetas shqiptar , i datelindjes 21.02.1952 , lindur në Kuçovë dhe banues në Lgj.Nr.1 Blloku "Tafil Skendo" Kuçovë , person madhor me zotësi juridike për të vepruar , mbajtes i letërnjoftimit me nr .028908841 dhe nr. Personal F 20221020R , si Kryetar i Keshillit Mbikëqyres të K.F."Naftetari" sh.a .



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi Nr. 55 u miratua me 20 vota pro , — vota kundër ,
— vota abstenim , të pranishëm 20 keshilltare .

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK
Arqile **MJESHTRI**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOREVE VLORE
NOTERE NATASHA STEFA
NR 1065 Rep Nr 796 Kol



KONTRATE DHURIMI AKSIONESH

Ne Kucove, sot me daten 31.08.2012/dymije e dumbedhjte/,para meje noteres Natasha Stefa , u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

PALA DHURUESE; Beshir Troka, I biri I Iljazit , I dtl. 15.04.1962,lindur ne Fier dhe banues ne Rruga Ismail Qemali pallati Samos Nr 31 Tirane ,Aksioner ne shoqerise Anonime KF Naftetari, me qender ne Kucove / ne Stadiumin Bashkim Sulejmani/, I identifikuar me leter njoftimi Nr 026362886 I paisur me dokumentet e subjektit.

PALA PRANUESE E DHURIMIT: Bashkia Kucove, perfaqesuar nga Nenkryetari I saj Zoti Shpetim Nishani, I biri I Dautit , I dtl. 21.02.1952,banues ne lagjen Tafil Skendo Kucove ,I identifikuar me leter njoftimi Nr 028908841,aksinere ne shoqerine Anonime sportive Naftetari Kucove

Te cilet jane madhore,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, qe me vullnet te lire me deklarojne sa me poshte:

PALA DHURUESE deklarone Une jam aksioner ne shoqerine Anonime sportive Naftetari sikunder vertetohet nga dokumenti QKR I paraqitur prej meje dhe I bashkelidhur kesaj kontrate .Aksionet e mija ne kete shoqeri jane 2450 000/dy million e katerqind epesedhjet mije/ leke me pjesemarje 70 %. Keto aksione une ja dhuroj Bashkise Kucove e cila eshte edhe ajo aksionere ne kete shoqeri ku jam edhe une si aksioner.

PALA QE PRANON DHURIMIN deklarone : Jemi dakord qe te pranojme dhuraten qe na ben aksioneri I shoqerise sportive NAFTETARI SHA zoti Beshir Troka ,konkretisht aksionet prej 2450000 leke qe perfaqesojne 70% te vleres totale.

Ne kete menyre pala dhuruese del nga shoqeria dhe nuk e konsideron me veten si mandat mbajtes dhe aksioner ne shoqerine sportive NAFTETARI SH A ndersa pala QE PRANON DHURIMIN behet zoteruese e aksioneve qe zoteronte pala PALA DHURUESE ne kete shoqeri.

Kjo kontrate detyron administraten e shoqerise se mesiperme qe te beje ndryshimet perkatese ne rregjistrin themeltar te kutave,ku pala DHURUESE crregjistrohet perfundimisht si aksionere e kesaj shoqerie dhe rregjistrimin e ketyre aksioneve ne favor te pranuesit te dhurimit qe eshte Bashkia Kucove ,e cila behet pronare e aksioneve te mesiperme duke ju shtuar aksionet e saj ne masen e mesiperme ,persa kohe ajo eshte aksionere ne shoqerine e mesiperme.

Bashkelidhur jane dokumentet e ted y paleve . Une noterja ligjeroj vullnetin e lire te paleve conform neneve 761 e vijues te Kodit Civil.

PALA DHURUESE

PALA QE PRANON DHURIMIN

NOTERE

Per Bashkise Kucove
Shpetim Nishani

Beshir Troka

Natasha Stefa
Stefa